



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Datë /a/e:	21.02.2020
Referencë:	07-353/04-38820/20
Për / Za/ To:	Qendra për Shërbime Sociale dhe Hulumtime - Prishtinë
Nga/ Od/ From:	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Kontrollloi:	Habib Qorri
Punoi:	Sabri Gashi
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit përmes QSHQ, ka pranuar kërkesën e Qendrës për Shërbime Sociale dhe Hulumtime nga Prishtina, për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin "Zahir Pajaziti".
Qëllimi i kërkesës ka të bëjë me organizimin e aktivitetit "Dita Ndërkombëtare e „Zero Diskriminim”".
Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, nën shkronja g), i) të Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike, nr.01-110-157481, i jep

Pëlqimin

Qendra për Shërbime Sociale dhe Hulumtime për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin „Zahir Pajaziti” para Hotel Grandit .
Shfrytëzimi i hapësirës ka të bëjë me organizimin e aktivitetit „dhënie e mesazhit për përmirësimin e kushteve, dhe diskriminimin e njerëzve nga institucionet, familjet etj, Organizimi i aktivitetit mbahet 01.03.2020 nga ora 12:00-15:00 ne baze të axhendes së organizatorit.
Për mbajtjen e aktivitetit i cili dhe quhet „Piramida e Diskriminimit” nevojitet një hapësirë 1.50x1.50 m .
Organizatori obligohet që:
- të mos paraqesin pengesë për lëvizjen e lirë të këmbësorëve;
- të kujdesen mirë për pjesëmarrësit gjate aktivitetit dhe të bashkëpunoj me Policinë e Kosovës për sigurimin e aktivitetit .
- Te mos shpërndaj broshura qe hedhen dhe krijojnë mbeturina .
- pas përfundimit të aktivitetit, hapësira të jetë e lirë si në gjendjen e mëparshme.
Po ashtu, nëse kërkohet ndonjë urgjencë nga Komuna, hapësira duhet të lirohet në afat kohor të cilin e kërkon Komuna.

Faqe 1 nga 1

Adresa: Rr. Ahmet Krasniqi, P.N. 10000 Prishtinë-Kosovë
<http://www.prishtina-komuna.org>